

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9426, DATË 6.10.2005, “PËR MBARËSHTIMIN E BLEGTORISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në kuadër të reformës së derregullimit dhe me qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, janë analizuar të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në anekset 1 dhe 2, të vendimit nr.538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

Në përfundim të analizës, ndër të tjera u arrit në konkluzionin se 23 licenca eliminohen.

Me anë të këtyre ndryshimeve synohet të arrihet:

- a) Reduktimi i barrierave administrative;
- b) Liberalizimi i tregut;
- c) Përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Neni 5, i ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se “Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, si rregull, kushtet e përgjithshme të licencimit, autorizimit dhe lejimit, organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve, organi kompetent për inspektimin dhe/ose për revokimin e licencës, autorizimit dhe lejes, si dhe shkaqet e revokimit përcaktohen me ligj, ndërsa kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit, dokumentet

shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë, autorizim apo leje, afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit miratohen me akt nënligjor, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizim apo leje.”.

Për sa më sipër, me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)” me kodin II.2.A.2. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimitarisë së ndërzimit natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror) do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e ndërzimit natyror duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e kësaj veprimtarie.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk përafron asnjë akt komunitar dhe nuk lidhet me zbatimin e ndonjë *acquis* specifik të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)”, me kodin II.2.A.2. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimitarisë së ndërzimit natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror) do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e ndërzimit natyror duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e kësaj veprimtarie.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Në projektligj përcaktohet se ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për marrjen e masave për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Projektligji i bashkëfirmosur me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është dërguar nëpërmjet sistemit e-aktet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, kjo ministri është shprehur dakord dhe pa komente.

Gjithashtu, për këtë projektligj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014, “Për njoftimit dhe konsultimin publik”, është hapur procesi i njoftimit dhe konsultimit publik në Regjistrin elektronik (RENJK), nga ku rezulton se nuk ka ardhur asnjë koment apo sugjerim gjatë periudhës së pritjes së tyre.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.

KËSHILLI I MINISTRAVE